



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 148 Datë 22.12.2021

Mbi miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 përfundimtar

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës duke u bazuar në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, të VKB nr. 89, datë 29.07.2021, “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve për Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, në nivel programi”, Udhëzimit nr. 23 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, sipas shkresës nga MFE me nr. 18976 datë 29.10.2021, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

- 1 Të miratojë programin buxhetor afatmesëm 2022-2024, përfundimtar, të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar.
- 2 Të miratojë të ardhurat e Bashkisë Korçë sipas formatit F1, “Parashikimi i burimeve të të ardhurave të njësisë së vetëqeverisjes vendore” për periudhën 2022-2024.
- 3 Të miratojë shpenzimet e Bashkisë Korçë sipas formatit F6 “Shpenzimet sipas nënfunkcionit dhe programit – vlera bruto” për periudhën 2022-2024.
4. Të miratojë shpenzimet për investime të Bashkisë Korçë sipas formatit F15 “Shpenzimet kapitale sipas programeve” për periudhën 2022-2024.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Korçë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Erjon Nexhipi

